Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e70-të, të mbajtur më 09.06.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12 - 1647/1 datë 20.04.2021, me pretendime për punën jo të rregullt në ISHP ///, HIDHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se, sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për këtë çështje, sepse KSHPK-ja tashmë ka vepruar për rastin pas denoncimit të dorëzuar në vitin 2019.

Lënda me numër 12 - 1647/1 të datës 20.04.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 20.04.2021, një parashtrues i njohur ka dorëzuar denoncim të regjistruar me numrin 12 - 1647/1 të datës 20.04.2021, në lidhje me lëndën që është trajtuar nga KSHPK-ja dhe i cili është themeluar në bazë të pretendimeve ndaj drejtorit të ///, për funksionim jo të rregullt dhe ushtrim presioni ndaj një punonjësi. Parashtruesi denoncimin e lëndës m e dorëzon si punonjës i institucionit shëndetësor të përmendur, i cili është i prekur personalisht dhe profesionalisht në lidhje me rastin e përmendur. Bëhet fjalë për një lëndë të dorëzuar në KSHPK pas denoncimit të dorëzuar më 15.11.2019 nga një parashtrues i njohur, i regjistruar me numër 12-5219/1, datë 15.11.2019, me pretendime ndaj drejtorit të ///, për funksionim jo të rregullt dhe ushtrim presioni ndaj një punonjësi në shërbimin financiar me qëllim të pagesës së dëmshpërblimit për jetën e ndarë nga familja, që paraqet keqpërdorim të kryerjes së funksioneve publike dhe arritjen e përfitimit personal për drejtor, në dëm të punonjësit dhe buxhetit të ISHP-së.

Denoncimi në fjalë është dorëzuar në lidhje me kërkesën e vitit 2019, sepse parashtruesi ndjeu një detyrim moral dhe profesional për të trajtuar personalisht rastin sipas të cilit KSHPK-ja ka vepruar.

Parashtruesi sqaron se gjatë kohës që ishte e punësuar në detyrën e ushtrueses së detyrës së drejtoreshës në ISHP-në në fjalë, po ashtu ishte duke kryer një specializim në pediatrinë ambulatore, por për të njëjtën ka qenë në dijeni Bordi Drejtues dhe me miratimin e tij ka vazhduar të punojë si /// i institucionit dhe me specializim . Sipas kërkuesit, urdhri i datës 29.10.2020 për kthimin e mjeteve për dëmshpërblim për

jetën e ndarë për periudhën sa mbante postin e drejtorit ekzekutiv është miratuar në mënyrë të paligjshme dhe i është refuzuar 1/3 e pagës, për këtë arsye ai ka paraqitur një kundërshtim.

Gjithashtu, raporton edhe në lidhje me shpalljen e shpallur në ISHP për përzgjedhjen e drejtorit, në të cilin parashtruesi ishte njëri nga tre kandidatët si i vetmi kandidat që i plotësonte kushtet, por pas të cilit nuk ishte marrë vendim për përzgjedhje nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, por u emërua një drejtor i ri. Për këtë, parashtruesi ngriti padi në gjykatën administrative, e cila vendosi rrëzimin e padisë dhe se ministri ka të drejtën diskrecionare për të bërë zgjedhje në bazë të shpalljes.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve, KSHPK konstatoi se tashmë ka vepruar ndaj lëndës me të njëjtën pasqyrë të pretendimeve me lëndën në fjalë, e cila është formuar sipas denoncimit dhe e regjistruar me numër 12-5219/1 nga 15.11.2019 e dorëzuar në KSHPK nga një parashtrues i njohur, ndaj të cilës në seancën e 42 të mbajtur më datë 27.11.2020 nga ana e KSHPK-së në bazë të gjendjes faktike të përcaktuar për rastin u miratua vendimi me numër 12-1220/15 nga 01.12.2020. Me vendimin në fjalë është vendosur që procedura për lëndën e formuar pas denoncimit të dorëzuar të ndërpritet, KSHPK-ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në këtë rast dhe i është dorëzuar njoftim Ministrit të Shëndetësisë me kërkesën e tij për veprim kompetent lidhur me rastin në fjalë, dhe në atë drejtim të ndërmerren masat dhe aktivitetet përkatëse lidhur me veprimin e parakohshëm të përmendur, si dhe për tejkalimin e kushteve të konstatuara në ISHP në fjalë.

Në lidhje me vendimin e KSHPK-së, më 8 mars 2021, u mor raport nga Drejtori i ///, deri te ///kabineti i ministrit të Shëndetësisë, duke raportuar për veprimet e marra në lidhje me rastin e formuar në KSHPK. Në fakt, kundër personit të denoncuar është ndërmarrë veprim dhe është miratuar Vendimi i borxhit nga 22.01.2021, me të cilin personi angazhohet të kthejë kompensimin e paguar në mënyrë të padrejtë në llogarinë e shtëpisë së shëndetësisë dhe të kryejë pagesën brenda 90 ditëve. Kundër këtij vendimi personi i denoncuar/prekur ka parashtruar ankesë në Komisionin Shtetëror në shkallë të dytë.

Nisur nga gjithçka që u tha më sipër, KSHPK-ja ka konstatuar se në lidhje me rastin në fjalë, KSHPK-ja tashmë ka vepruar sipas denoncimit të dorëzuar në vitin 2019, ka vendosur për të gjitha pretendimet në fjalë dhe ka marrë një vendim për rastin e trajtuar, i cili ka të njëjtin përshkrim faktik të pretendimeve me pretendimet në fjalë dhe në të njëjtën kohë Ministrit të Shëndetësisë i është dorëzuar njoftim dhe kërkesë për veprim kompetent për rastin në fjalë me vendimin e miratuar të KSHPK-së, me të cilin është vepruar nga organi kompetent dhe janë ndërmarrë veprime për tejkalimin e kushteve të konstatuara në institucionin publik shëndetësor në fjalë. Prandaj, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndë dhe vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar: - parashtruesit

Përgatiti: J.C.